

Nr. prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “TMC Training Management Consulting” sh.p.k. me NIPT K81826007A me adresë: Rr. Hamdi Shijaku, Pallati 6/3, Kati I - rë, Njësia Bashkiake nr. 9 Tiranë, me përfaqësues ligjor z. Leonat Luli.

Procedura e prokurimit: REF-08231-10-14-2021, me objekt: “Projekti i çertifikimit me ISO sipas standarteve ndërkombëtare për Albcontrol sha”, me fond limit 108,250,000 (njëqind e tetë milion e dyqind e pesedhjetë mijë) lekë pa tvsh ose 890,287 (tetëqind nëntëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) Euro pa tvsh

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 15 Nëntor 2021, ora 11:00.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nuk ka.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “TMC Training Management Consulting” sh.p.k. me NIPT K81826007A
  - Çmimi i ofertës: 108 000 000 (njëqind e tetë milion) lekë pa tvsh
2. Ofertuesi i dytë: Bashkim i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë “ICDQ Instituto de Certification dhe Cavala Gabinete de Asesoria” sh.p.k. me NIPT B-82280798 & B84855436
  - Çmimi i ofertës: 642 200 (gjashtëqind e dyzet e dy mijë e dyqind) euro pa tvsh
3. Ofertuesi i tretë: Operatori Ekonomik “Resuli ER” sh.p.k. me NIPT L12510413V
  - Çmimi i ofertës: Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

4. Ofertuesi i katërt: Operatori Ekonomik “Eurogjici-Security” sh.p.k. me NIPT K31929010K

- Çmimi i ofertës: Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

**Janë skualifikuar:**

1. Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve ekonomik “ICDQ Instituto de Certificacion SL and CAVALA GABINETE DE ASESORÍA EMPRESARIAL SL” me NIPT B-82280798 & B84855436

Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve ekonomik nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta e BOE “ICDQ-CAVALA”, nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

- a) Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve ekonomik nuk plotëson kriterin e parashikuar në pikën 1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se ofertuesi duhet të paraqesë: *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*  
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kriterin e mësipërm thekson se BOE, nuk e përmbush kriterin për shkak se nuk ka dorëzuar në SPE formularin e sigurimit të ofertës në përputhje me nenin 83 të LPP, “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.
- b) Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve ekonomik nuk plotëson pikën 2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, pasi për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik kanë paraqitur në SPE vërtetim për xhiron mesatare dhe bilance për vitet 2018, 2019 dhe 2020 në gjuhën spanjole dhe të pa përkthyer në një nga gjuhët e procedurës së prokurimit.
- c) Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1, të kapacitetit teknik, pasi në dokumentacion e ngarkuar në SPE, operatorët ekonomik nuk dëshmojnë që të kenë realizuar shërbime të ngjashme në një vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet.  
Për të dëshmuar se plotësojnë këtë kriter operatori ekonomik “Cavala Gabinete De Asesoría Empresarial SL” ka ngarkuar në SPE një kontratë të ngjashme ku operatori ekonomik është *join venture* në këtë kontratë dhe nuk përcaktohet pjesa e shërbimit që është realizuar nga operatori ekonomik “Cavala Gabinete De Asesoría Empresarial SL”. Ndërsa operatori ekonomik “ICDQ” ka paraqitur si dëshmi për shërbime të ngjashme vetëm referenca të shërbimeve të pashoqëruara me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- d) Anëtari i këtij BOE “ICDQ Instituto de Certificacion SL” nuk plotëson pikën 2.3.2, pikën 2.3.4 dhe pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë

dokumentacion që të provojë se zotëron certifikatat ISO 9001:2015; ISO/IEC 27001:2013 dhe ISO 45001:2018;

- e) Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve ekonomik kanë deklaruar në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit se parashikojnë nënkontraktim të shërbimeve dhe konkretisht të nënkontraktorët INECO dhe Secure & IT, në kundërshtim me pikën 2.15.1 të DST pasi në këtë procedure nuk parashikohet nënkontraktimi.
- f) Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve ekonomik nuk kanë plotësuar të gjitha kërkesat e Shtojcës 9, Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në përputhje me pikën 1 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, pasi Pjesa II, Deklarata A është lënë e pa plotësuar nga operatorët ekonomik.
- g) Dokumentacioni i ngarkuar nga Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve ekonomik në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet publike nuk janë të certifikuar me vulën “Apostile” apo të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse apo nga një organ tjetër kompetent.

## 2. Operatori ekonomik “Eurogjici-Security” shpk

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se shoqëria “Eurogjici-Security” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik asnjë dokument të kërkuar sipas DST. Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## 3. Operatori ekonomik “Resuli-Er” shpk

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se shoqëria “Resuli-Er” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik asnjë dokument të kërkuar sipas DST. Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Operatori Ekonomik “TMC Training Management Consulting” sh.p.k. me NIPT K81826007A me adresë: Rr. Hamdi Shijaku, Pallati 6/3, Kati I - rë, Njësia Bashkiake nr.9 Tiranë, me përfaqësues ligjor z. Leonat Luli, ka paraqitur ofertën me vlerë 108 000 000 (njëqind e tetë milion) lekë pa tvsh, e cila është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**HANTIN BONATI**